



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1231/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Pajtim Hodollit - Kandidat për Asamble Komunale (PDK) dega në Podujevë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV) dega në Podujevë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Pajtim Hodollit - Kandidat për Asamble Komunale (PDK) dega në Podujevë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:45 nga parashtruesi i ankesës Pajtim Hodolli - Kandidat për Asamble Komunale ku pretendohet se, në VV 1803E/01R unë jamë dëmtuar, pasi që sipas rezultateve të shpallura nga KQZ-ja kandidati tjetër Naim Çunaku i figurojnë 71 vota, gjë që po të ishte numëri i votave i të lartpërmendurit 23 unë do të isha asamblesit, prandaj bazuar në rezultatet e KKZ-së, unë kamë 394 vota, kurse Naim Çunaku 34, ndërsa sipas rezultateve të KQZ-së unë i kamë 380 vota dhe Naim Çunaku i ka 394 vota. Më tutja ka theksuar kërkoj nga PZAP-i të shikoj vendvotimet VV1816E/03D, 1813E/02D, 1801X/01R, 1801X/02R, 1801X/03R, 1801X/04R. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur kopjet e formularëve nga KKZ-ja në Podujevë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga Pajtim Hodolli - Kandidat për Asamble Komunale (PDK) dega në Podujevë pretendohet se në, vendvotimet VV 1816E/03D, 1813E/02D, 1801X/01R, 1801X/02R, 1801X/03R, 1801X/04R jamë dëmtuar, mirëpo një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohet se është kryer një veprim i ndaluar.

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë ankimorë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1231/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.